



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/117
Datë: 29.12.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 14 paragrafit 1, nenit 15 paragrafit 4, dhe të nenit 23, të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-143, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022 dhe Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje të mjeteve buxhetore në vlerë prej 37,500,000.00 € (tridhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë euro) si në vijim:
 - 1.1. Në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213, nën-programi "Administrata Qendrore" me kod 11313, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" shuma prej 20,000,000.00 € (njëzet milionë euro); dhe
 - 1.2. Në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213, nën-programi "Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike" me kod 23300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" shuma prej 17,500,000.00 € (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë euro).
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren si në vijim:
 - 2.1. Nga kursimet buxhetore sipas Tabelës A, pjesë përbërëse e këtij Vendimi, shuma prej 20,000,000.00 € (njëzet milionë euro);
 - 2.2. Nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për zbatimin e masës 4.6 - Mbështetja e Ndërmarrjeve Publike të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, shuma prej 14,000,000.00 € (katërmëdhjetë milionë euro); dhe
 - 2.3. Nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" shuma prej 3,500,000.00 € (tre milionë e pesëqind mijë euro).

3. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/117
Datë: 29.12.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 paragrafi 1.1. të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 08-V-440 të datës 08.12.2022, për aprovimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/110 të datës 29.11.2022, duke u bazuar në Rekomandimin e Komitetit Teknik-Emergjent të datës 17.08.2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Në bazë të interesit publik, Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), si Ndërmarrje Publike e Energjisë, i vendoset obligimi për shërbim publik për të ndihmuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike, për periudhën 1 janar 2023 deri me 15 mars 2023 deri në 185 GWh, në rastet kur nuk plotësohen kërkesat e furnizimit me energji elektrike sipas pikës 2. të këtij Vendimi.
2. Sipas këtij obligimi për shërbim publik, KEK obligohet të importojë mungesën e sasinë së energjisë elektrike atëherë kur kapacitetet vendore gjeneruese dhe importi i siguruar nga ndërmarrjet tjera të energjisë është i pamjaftueshëm për të mbuluar kërkesën e Kosovës për energji elektrike.
3. KEK energjinë elektrike të siguruar nga importi do ta nominojë si gjenerim të tij, dhe të jap në dipozicion sipas kushteve të parapara në Marrëveshjen ekzistuese për Blerje me Shumicë mes palëve dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, KOSTT.
4. KEK për blerjen e importit të munguar të energjisë elektrike, do të shfrytëzojë mjetet e mbetura nga subvencioni i Ministrisë së Ekonomisë sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 05/55 të datës 21.02.2022, dhe këto mjetet do të zbriten nga vlera e subvencionit e nënvizuar në Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) V-1486-2022 të datës 07.02.2022 dhe V-1489-2022 të datës 08.02.2022.
5. KEK do të kryej këtë obligim për shërbim publik sipas disponueshmërisë së mjeteve dhe zotimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbuluar koston e këtij shërbimi sipas këtij Vendimi, deri në 37 milion Euro përtej shumës së përcaktuar në pikën 4. të këtij Vendimi.
6. Mjetet financiare të ndara për këtë qëllim do të transferohen nga Ministria e Ekonomisë në një llogari të veçantë tek KEK. KEK do të shfrytëzojë këto mjete në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas këtij Vendimi.

7. Udhëzohet Bordi Drejtues i KEK që të ndërmarrë të gjitha veprimet për sigurimin e zbatimit të këtij Vendimi.
8. Në zbatim të këtij Vendimi, KEK do të raportojë tek Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrinë e Ekonomisë në baza mujore dhe sipas kërkesës. KEK obligohet ta ruajë tërë dokumentacionin lidhur me shpenzimin e këtyre mjeteve për qëllime të auditimit.
9. Ky Vendim nuk ndikon në çështjet tjera ku përfshihen të drejtat dhe obligimet e ndërmarrjeve të energjisë sipas vendimeve të nxjerra nga ZRRë në përputhje me legjislacionin në fuqi apo marrëveshjet e tjera ndërmjet palëve që i paraprijnë këtij Vendimi dhe që kanë rëndësi për sigurinë e furnizimit të energjisë.
10. Obligohet Ministria e Ekonomisë, Ministra e Financave, Punës dhe Transfereve, institucionet dhe entitet tjera përgjegjëse të veprojnë sipas kompetencave të tyre ligjore për zbatimin e këtij Vendimi.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë